

Amendim i RIO-s së Albtelecom per te mundesuar shërbimin e Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit

1. Në nenin 4 “Baza Juridike”, shtohet pikat 2/1, 3/2, 3/3 dhe pika 7 si më poshtë:

- 2/1 Vendimi nr. 1650 dt. 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e e dokumentacionit për implementimin dhe rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”*
- 3/2. Rregullore nr. 13 për Zgjedhjen e Bartësit dhe Para-Zgjedhjen e Bartësit, miratuar me Vendim nr.1650 dt. 29.06.2011*
- 3/3 Vendim nr. 1692 dt. 19.09.2011 “Shyrtimin e ankimit administrativ te Albtelecom ne lidhje me aktin administrativ, Vendimit nr. 1650 dt. 29.06.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e e dokumentacionit për implementimin dhe rregulloren e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit”*
- 7. Albtelecom do të ofrojë për operatorin kërkues për mundësimin e shërbimit për zgjedhjen e bartësit dhe/ose parazgjedhjen e bartësit për ata operatorë të cilet plotësojnë tre kushtet e mëposhtme:*
- (a) Janë regjistruar zyrtarisht në Rregjistrin e Sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, për ofrimin e rrjeteve publike të telefonisë.*
- (b) Kanë nënshkruar një marrveshje interkoneksioni me Albtelecom, dhe*
- (c) Janë pajisur me prefiks të bartësit të thirrjeve sipas procedurave përkatëse të AKEP.*

2. Në neni 11 “Shërbimet e Interkoneksionit”, shtohet pika 8 dhe pika 9 si më poshtë:

- 8. Albtelecom ka detyrimin të ofrojë mundësinë e shërbimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B) për të gjithë pajtimtarët që përdorin paketat tarifore standarte dhe nuk ka detyrim të aplikojë zgjedhjen e bartësit dhe/ose parazgjedhjen e bartësit për ata pajtimtarë që kanë nënshkruar kontratë pajtimi me Albtelecom me paketa të veçanta tarifore*
- 9. Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur nuk duhet të shkaktojë pasoja juridike tek kontrata aktuale e pajtimtarit me Albtelecom për të shmangur detyrimet qe pajtimtari ka ndaj Albtelecom për shërbimet e përfituara prej tij më parë dhe/ose që vazhdon të përfitojë.*

3. Në nenin 15 “Paraqitja e Identifikimit të Linjës Thirrëse (CLI)”, shtohet pika 4/1 dhe 4/2 si më poshtë:

- 4/1 Në rastin e shërbimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B), Albtelecom dhe operatori i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur janë të detyruar të bëjnë të mundur identifikimin e numrave thirres ose numrave të thirrur.*

4/2 Operatori bartës i thirrjeve duhet të plotësojë të gjitha detyrimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator për ofrimin e shërbimeve të komunikimit publik si p.sh. CLI, ruajtja e të dhënave, përgjimi i ligjshëm i komunikimeve.

4. Në nenin “Shkelja, Pezullimi dhe Zgjidhja e Marrëveshjes së Interkoneksionit” shtohet pika 1/2 si më poshtë:

1/2 Ndërprerja apo përfundimi i Marrëveshjes së Interkoneksionit mes operatorit dhe Albtelecom sjell ndërprerjen e ofrimit të shërbimit të parazgjedhjes së bartësit

5. Në Ankes 1 “Përkufizime”, shtohen përkufizimet si më poshtë:

Z(P)B: Zgjedhja dhe/ose parazgjedhja e bartësit.

ZB: Zgjedhja e bartësit ne fillmi te thirrjes.

PB: Parazgjedhja e bartësit.

Operator i rrjetit të aksesit: nënkupton një operator rrjeti publik telefonik, i cili ofron pajtimtarit akses në rrjetin publik telefonik, dhe ndaj të cilit i është vendosur detyrimi (në këtë rast Albtelecom) për të mundësuar pajtimtarëve të rrjetit të tij aksesin në shërbimet e çdo ofruesi të rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, të interkonektuar me të, nëpërmjet zgjedhjes dhe/ose parazgjedhjes se bartësit.

Bartës i thirrjeve me Z(P)B: është një operator i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur.

Operator i Zgjedhur nënkupton një operator të rrjeteve të komunikimeve publike i interkonektuar me Operatorin e Rrjetit të Aksesit i cili ofron shërbime publike telefonike dhe zgjidhet nga pajtimtari i Operatorit të rrjetit të aksesit, duke përdorur Prefiksin e zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes telefonike.

Operator i Parazgjedhur: nënkupton një operator të rrjeteve të komunikimeve publike i interkonektuar me Operatorin e Rrjetit të Aksesit, i cili ofron shërbime telefonike publike dhe që pajtimtari i Operatorit të Rrjetit të Aksesit e ka deklaruar atë si ofrues të disa shërbimeve publike telefonike, në bazë të një kontrate të nënshkruar më parë midis pajtimtarit dhe këtij operatori.

Zgjedhje e Bartësit në fillim të thirrjes: nënkupton procedurën me të cilën pajtimtari i Operatorit të Rrjetit të Aksesit,

mund të kryejë zgjedhjen e bartësit në fillim të thirrjes duke formuar prefiksin e bartësit të zgjedhur përpara numrit telefonik që thirret.

- Parazgjedhja e Bartësit:** *nënkupton një procedurë të programuar më parë, për t'i bërë të mundur pajtimtarit të Operatorit i Rrjetit të Aksesit, të lidhet me bartësin e parazgjedhur, me të cilin ka nënshkruar më parë një kontratë për ofrimin e disa shërbimeve telefonike, pa i hequr mundësinë pajtimtarit të zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes*
- Prefiksi i Bartësit të Zgjedhur/parazgjedhur:** *nënkupton një numër me katër shifra në formatin “10xx” ku “xx” është prefiksi i operatorit të zgjedhur i caktuar nga AKEP në përputhje me Planin e Numeracionit të Republikës së Shqipërisë.*
- Thirrje Lokale:** *nënkupton një thirrje të origjinuar nga pajtimtari i një zone gjeografike nga rrjeti i një operatori rrjeti telefonik fiks tek një pajtimtar në të njëjten zonë gjeografike pa qënë nevoja e formimit të prefiksit të zones gjeografike të pajtimtarit të thirrur.*
- Thirrje Kombëtare:** *nënkupton një thirrje të origjinuar nga pajtimtari i një rrjeti publik telefonik në një zonë gjeografike drejt një pajtimtari rrjeti publik telefonik fiks në një zonë tjetër gjeografike duke formuar prefiksin përkatës (kombëtar dhe kodin e kësaj zone gjeografike) përpara numrit të pajtimtarit të thirrur.*
- Thirrje ndërkombëtare:** *nënkupton një thirrje të origjinuar nga pajtimtari i një rrjeti publik telefonik tek një pajtimtar në një shtet tjetër duke formuar një prefix ndërkombëtar dhe kodin e shtetit përpara numrit kombëtar të pajtimtarit të thirrur, i lidhur në një rrjet publik fiks ose mobil.*
- Të gjitha thirrjet:** *nënkupton të gjitha kategorite e thirrjeve përveç thirrjeve drejt numrave të emergjencës.*

6. Në Aneks 2 “Interkoneksioni me rrjetin Albtelecom”, shtohet seksioni 7/1 “Interkoneksioni për mundësimin e ofrimit të shërbimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B)” si më poshtë:

7/1 “Interkoneksioni për mundësimin e ofrimit të shërbimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B)”

Për ofrimin e shërbimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B) ndaj përdoruesit fundor, operatori i zgjedhur ose i parazgjedhur do duhet të përdorë infrastrukturën e rrjetit të Albtelecom (linja fizike që lidh pajtimtarin me operatorin e rrjetit të aksesit Albtelecom) që shërben për të realizuar një pjesë të thirrjes (deri në pikën e interkoneksionit midis Albtelecom me operatorin e (para)zgjedhur) dhe për këtë shërbim kryhen pagesat për shërbim me shumicë të origjinimit të ofruar nga operatori i rrjetit të aksesit Albtelecom për operatorin e (para)zgjedhur

*Në rastin e **Zgjedhjes së Bartësit në fillim të thirrjes** (Call-by-call Carrier Selection-CS), Operatori që i ofron pajtimtarit aksesin në rrjet analizon prefiksin e formuar(10xx ku xx janë shifrat që identifikojnë operatorin e zgjedhur) dhe rrugëzon thirrjen drejt operatorit nëpërmjet pikës më të afërt të interkoneksionit që ka me këtë operator. Pastaj është përgjegjësia e operatorit të zgjedhur që të kontrollojë nëse pajtimtari është i autorizuar të përdorë këtë shërbim, të çojë thirrjen në destinacionin e zgjedhur si dhe të bëjë faturimin e përdoruesit për thirrjen, përfshirë procesin e pagesës së pajtimtarit për shërbimin e kryer.*

*Në rastin e **Para-Zgjedhjes së Bartësit** (Carrier Pre-Selection-CPS), në centralin e Albtelecom që i ofron aksesin në rrjet pajtimtarit, sipas zgjedhjes së pajtimtarit, programohet si default ky operator i zgjedhur për thirrjet e pajtimtarit. Para-zgjedhja e këtij bartësi mund të kryhet për lloje të caktuara të thirrjeve sipas kategorive (lokale, kombëtare drejt fiks apo celulare dhe ndërkombëtare) ose për të gjitha thirrjet ('all calls' option)*

*Në rastin e **Para-Zgjedhja e Bartësit me shmangie (ri-zgjedhje)** (Carrier Pre-Selection ëith override) kemi kombinimin e dy rasteve të përmëndura më lart.*

7. Në Aneks 3 “Përshkrimi i Shërbimeve”, shtohet seksioni I.1.4 “Shërbimi i origjinimit nga rrjeti Albtelecom” si më poshtë:

I.1.4 “Shërbimi i origjinimit”

Albtelecom ofron shërbimin e origjinimit për operatorët e interkonektuar me Albtelecom për mundësimin e ofrimit të shërbimit të të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B) për pajtimtarët e Albtelecom në përputhje me Rregulloren për Zgjedhjen dhe Para-Zgjedhjen e Bartësit. Operatori i (para)zgjedhur do të paguajë për shërbimin e origjinimit tarifën sipas segmentit dyfish të origjinimit.

Albtelecom ofron shërbimin e origjinimit për thirrjet e gjeneruara nga pajtimtarët e tij nëpërmjet shërbimit të Z (P) B në emër të operatorit të (para)zgjedhur deri në Pikën e Interkoneksionit me këtë operator të identifikuar nga numeracioni gjeografik nga ku është gjeneruar thirrja dhe nëpërmjet prefiskit të operatorit që ofron këtë shërbim duke krijuar një qark të komutuar nga pika fundore që ka origjinuar thirrjen deri në Pikën e Interkoneksionit të Albtelecom me këtë operator.

Tarifat për shërbimin e origjinimit jepen në Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve”

8. Në Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve”, shtohet seksioni I.1.4 “Shërbimi i origjinimit nga rrjeti Altelecom” si më poshtë:

I.1.4 shërbimi i origjinimit nga rrjeti Altelecom për të mundësuar ofrimin e shërbimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-Zgjedhjes së Bartësit (Z(P)B) për pajtimtarët e Altelecom në referencë me shërbimin e prshkruar në Aneks 3 “Përshkrimi i Shërbimeve”, seksioni I.1.4 ofrohet si më poshtë:

Sherbimi Trafikut Origjinim sipas pikes I.1.4	Tarifa
Segment i dyfishtë (Kombëtar)	3.5 lekë/min

Për cdo thirrje të origjinuar aplikohet një tarifë fikse 0.83 lekë për thirrje të suksesshme.

9. Në Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve” shtohet seksioni I.5 “Pagesat në lidhje me Z(P)B”

I.5 Pagesat e operatorit për Altelecom në lidhje me Z(P)B”

- 1. Tarifë për implementimin e prefiksit të zgjedhjes së bartësit (ZB). **1,810,000 Lek** (vetëm njëherë)*
- 2. Pagesë mujore nga ana e operatorit duke filluar që nga data kur është bërë transaksioni i parë për të mbuluar koston e menaxhimit “live” në vazhdimsi të këtij produkti nga ana e operatorit të aksesit. **278,000 Lek/muaj***
- 3. Pagesa e operatorit për administrimin e kërkesave nga Altelecom, (aktivizimin/ndryshim/anullimin/pezullimin) e Z(P)B për cdo pajtimtar, për të bërë konfigurimet përkatëse në sistemin Altelecom që të mundësojë për cdo pajtimtar për të cilin është kërkuar (aktivizimi/ndryshimi/anullimi/pezullimi) e Z(P)B. **100 Lek/për kërkesë***
- 4. Tarifë për implementimin e Z(P)B për cdo linjë telefonike, kjo tarifë paguhet vetëm njëherë nga bartësi i thirrjeve për cdo pajtimtar **690 Lek/pajtimtar***
- 5. Pagesë për implementimin e prefiksit për PB e shprehur në tarifë për të gjitha centralet **1,810,000 lek***
- 6. Pagesë për minute (surcharge per minute) për rikuperimin nga kostoja e shkaktuar rrjetit për të mundësuar Z(P)B. Kjo pagesë do të vazhdojë për një periudhë prej 5 vjetësh (e ndryshueshme) deri sa të rikuperohen kostot e rrjetit **0.5 lek/min***

10. Në Aneks 5 “Cështje Teknike”, shtohet pika 8.3 “Parime të rrugëzimit në shërbimin e Z(P)B” si më poshtë:

8.3 Parime të rrugëzimit në shërbimin e Z(P)B

Operatori i rrjetit të aksesit Albtelecom rrugëzon thirrjet e pajtimtarit të tij në drejtim të operatorit të zgjedhur dhe/ose parazgjedhur, i cili përveç kërkesave rregullatore, duhet të realizojë të gjitha thirrjet lokale, kombëtare dhe/ose të gjitha thirrjet ndërkombetare, në përputhje me marrëveshjen e interkoneksionit të nënshkruar midis tij dhe Albtelecom për ofrimin e aksesit për Z(P)B.

11. Në Aneks 5 “Cështje Teknike”, shtohet pika 9.5 “Numërformimi në rastin e Z(P)B” si më poshtë:

9.5 Numërformimi në rastin e Z(P)B

Në këtë rast numërformimi do të jetë sipas përshkrimit të dhënë në dokumentin e miratuar me VKD nr. 1650 dt. 29.06.2011 “Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe PraZgjedhjes së Bartësit”, seksioni 2.4

12. Në Aneks 7 “Bashkëpunimi i Palëve”, shtohet pika 4/1 “Pikat e kontaktit për shërbimin e Z(P)B” si më poshtë:

4/1 Pikat e kontaktit për shërbimin e Z(P)B:

Secili operator duhet t'i japë operatorit tjetër (të përfshirë në procesin e parazgjedhjes së bartësit) adresat postare, e-mail, numrat e telefonit dhe fax të personave përgjegjës për parazgjedhjen e bartësit dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për procesin e parazgjedhjes së bartësit në përputhje me Rregulloren për Zgjedhjen e Bartësit dhe Para-Zgjedhjen e Bartësit dhe në përputhje me këtë RIO.

13. Në Aneks 9 “Matja, Deklarimi dhe Rakordimi i trafikut”, pika 1.3.2 përditësohet Tabela 1 edhe me shërbimin e origjimit në përgatitjen e informacionit për shërbimet e interkoneksionit